


Vdhëzues për mbrojtjen e të dhënave të të miturve



Hyrje

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka hartuar Udhëzuesin "Për mbrojtjen e të dhënave të të miturve", në zbatim të ligjit nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Ky dokument i drejtohet të miturve me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre mbi të drejtat që i garanton ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Përmes tij, synohet rritja e kuptueshmërisë mbi rëndësinë e përpunimit të ligjshëm, të drejtë dhe transparent të të dhënave të miturve. Gjithashtu, orienton ata të njohin rreziqet që lidhen me përdorimin e mjedisit digjital dhe teknologjive të reja si dhe shërben për marrjen e masave të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me interesin më të lartë të të miturve dhe respektimin e të drejtave të tyre themelore.

Përkuftizime

1. "Të dhëna personale të të miturve" janë të dhëna që i përkasin personave nën moshën 18 vjeç, të cilët për shkak të moshës dhe zhvillimit të tyre, kërkojnë një nivel të shtuar mbrojtjeje në procesin e mbledhjes dhe përpunimit të informacioneve.

2. "Përpunim i të dhënave personale" është çdo veprim ose një grup veprimesh, që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.

3. "Pëlqim" është çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht, i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklaratë ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshimtë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike.

4. "Cenim i të dhënave personale" është çdo cenim i sigurisë, që mund të shkaktojë në mënyrë aksidentale ose të paligjshme shkatërrimin, humbjen, ndryshimin, përhapjen ose aksesin e paautorizuar të të dhënave personale të ruajtura, transmetuara ose përpunuara në ndonjë mënyrë tjetër.



5. **“Subjekt i të dhënave”** është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifik, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror.

6. **“Të dhëna sensitive”** janë kategori të veçanta të të dhënave personale, që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, besimin fetar ose pikëpamjet filozofike, anëtarësimin në sindikata, të dhënat gjenetike, të dhënat biometrike, të dhënat për shëndetin, jetën ose orientimin seksual të një personi.


7. **“Përpunues”** është personi fizik ose juridik dhe çdo autoritet publik, i cili përpunon të dhëna personale për llogari të kontrolluesit.

8. **“Kontrollues”** është personi fizik ose juridik dhe çdo autoritet publik, i cili vetëm ose së bashku me të tjerët, përcakton qëllimet e mjetet e përpunimit të të dhënave personale. Për përpunimin e të dhënave personale, sipas dispozitave të pjesës së III të këtij ligji kontrolluesi është autoriteti kompetent, i cili vetëm ose së bashku me të tjerët, përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale.

9. **“Palë e tretë”** është çdo person fizik ose juridik dhe çdo autoritet publik, me përjashtim të subjektit të të dhënave, kontrolluesit, përpunuesit apo personave, i cili nën autoritetin e drejtpërdrejtë të kontrolluesit ose të përpunuesit, është i autorizuar të përpunojë të dhëna personale.

Kuadri Ligjor

Mbrojtja e të dhënave personale është një e drejtë themelore e çdo individi dhe një element thelbësor i respektimit të privatësisë, dinjitetit dhe sigurisë personale, veçanërisht në mjedisin digjital. Në Republikën e Shqipërisë, e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale rregullohet nga **ligji nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”**, i cili përcakton parimet, rregullat dhe detyrimet për autoritetet publike dhe subjektet private në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të çdo individi.





Ligji parashikon masa të posaçme për të miturit, duke njohur faktin se ata përbëjnë një kategori të ndjeshme dhe më të ekspozuar ndaj rreziqeve të përpunimit të paligjshëm ose të pasigurt të të dhënave personale. Për këtë arsye, ligji synon t'u garantojë të miturve një nivel më të lartë mbrojtjeje, veçanërisht në përdorimin e shërbimeve digjitale dhe në mjediset online, duke përcaktuar rregulla të qarta për mënyrën se si duhet të mblidhen, përdoren dhe ruhen të dhënat personale të tyre.

Të dhënat personale të të miturve duhet të përpunohen vetëm kur është e nevojshme, për qëllime të ligjshme dhe në mënyrë të drejtë dhe transparente. Institucionet, shkollat, qendrat shëndetësore, platformat online dhe çdo subjekt tjetër që përpunon të dhënat e kësaj kategorie kanë detyrimin ligjor të mbrojnë dhe të shmangin çdo mbledhje ose përdorim të panevojshëm të të dhënave të tyre. Kur i mituri është nën moshën 16 vjeç, përpunimi është i ligjshëm vetëm kur pëlqimi jepet ose autorizohet nga prindi ose kujdestari i tij ligjor dhe për aq sa jepet ose autorizohet prej tij.

Ligji nr. 124/2024, ndalon përdorimin e të dhënave të të miturve për qëllime si marketingu, profilizimi apo monitorimi, përveç rasteve kur ekzistojnë garanci të posaçme ligjore për mbrojtjen e tyre. Gjithashtu, ai u njeh të miturve të drejtën për t'u informuar mbi mënyrën se si përdoren të dhënat e tyre, duke kërkuar që ky informacion të jepet me një gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe të përshtatshme për moshën e tyre.

Ky kuadër ligjor është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale. Shqipëria është palë në Konventën nr. 108 të Këshillit të Evropës dhe Protokollin modernizues 108+, të cilat kërkojnë që përpunimi i të dhënave të fëmijëve të jetë i ligjshëm, proporcional dhe i sigurt, duke respektuar gjithmonë interesin më të lartë të tyre.

Po ashtu, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale pasqyron parimet e **Rregullores së BE-së 2016/679 - GDPR**, e cila parashikon mbrojtje të posaçme për të miturit, veçanërisht në mjedisin online, dhe kërkon pëlqimin e prindërve për përdorimin e shërbimeve digjitale.



Çfarë është Mbrojtja e të Dhënave Personale?

Mbrojtja e të dhënave personale është një nga themelet kryesore të të drejtave të njeriut në epokën digjitale. Në shoqërinë moderne, ku teknologjia është integruar në çdo aspekt të jetës, të dhënat personale qarkullojnë me shpejtësi të madhe përmes platformave online, pajisjeve inteligjente, rrjeteve sociale, aplikacioneve mësimore dhe shërbimeve të ndryshme digjitale.

Çdo individ lë gjurmë në mjedisin online dhe shpesh këto të dhëna mund të përpunohen, ruhen, shpërndahen ose abuzohen pa dijeninë e tyre, duke rritur ndjeshëm rrezikun e aksesimit të paautorizuar, publikimit të pavullnetshëm, abuzimit apo humbjes së informacionit.

Prandaj, mbrojtja e të dhënave nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një domosdoshmëri për të mbrojtur informacionin personal, sigurinë, dinjitetin dhe lirinë e çdo individi.

Kush i mbledh të dhënat?

Të dhënat personale të një individi, por veçanërisht të një të mituri, mund të mblidhen nga një sërë subjektësh që veprojnë në jetën e përditshme, si në mjedisin fizik ashtu edhe në atë digjital. Këto subjekte quhen kontrollues të të dhënave dhe janë përgjegjës për mënyrën se si mbledhin, përpunojnë dhe ruajnë informacionin personal. Njohja e tyre është thelbësore për të kuptuar se ku ndodhen të dhënat dhe si duhet të mbrohen ato.

Të dhënat personale mblidhen gjithashtu edhe nga faqet e internetit, platforma të ndryshme, rrjete sociale dhe aplikacionet, të cilat përdoren nga vetë individët.

Në fakt shumë të dhëna që mblidhen rreth nesh gjenden lehtësisht në internet, pasi kur përdorim një aplikacion për planifikimin e itinerarit në telefon, ne ndajmë automatikisht informacione rreth vendndodhjes aktuale dhe destinacionit ku do të shkojmë. Po ashtu edhe kur përdorim rrjetet sociale, ne ndajmë informacione rreth vetes përmes shpërndarjes së fotove apo videove. Pra, çdo individ ndan të dhëna të panumërta personale në mjedisin online, kështu që ligji për mbrojtjen e të dhënave është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për të gjithë. Ai siguron që subjektet që i mbledhin këto të dhëna dhe informacione t'i mbajnë të sigurt dhe t'i përdorin në mënyrë të drejtë dhe transparente.



Për çfarë përdoren të dhënat personale nga shoqëritë tregtare ?

Shoqëritë tregtare përdorin të dhëna personale për të zhvilluar aktivitetin e tyre në mënyrë të organizuar, të ligjshme dhe të sigurt. Ky proces u mundëson atyre të ofrojnë shërbime më të përshtatura ndaj nevojave të individëve dhe të funksionojnë me efikasitet të lartë.

Për shembull, një spital përdor informacionin mbi historikun mjekësor dhe trajtimet e mëparshme për të ofruar kujdes shëndetësor të përshtatshëm. Po kështu, bizneset online i përdorin të dhënat për të përmirësuar shërbimet e tyre, si për shembull një platformë streaming mban mend se në cilin episod keni mbetur dhe ju rekomandon përmbajtje të ngjashme. Gjithashtu, përpunimi i të dhënave ndihmon shoqëritë tregtare të marrin vendime, të menaxhojnë nevoja të ndryshme dhe të sigurojnë respektimin e ligjit dhe rregulloreve në fuqi. Në këtë mënyrë, përdorimi i të dhënave personale siguron që shoqëritë tregtare të funksionojnë në mënyrë të ligjshme, transparente dhe të sigurt, duke mbrojtur të drejtat dhe informacionin personal të individëve.

Çfarë roli ka Komisioneri?


Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka një rol thelbësor në garantimin e mbrojtjes së të dhënave të të miturve. Ai është autoriteti përgjegjës për monitorimin e zbatimit të ligjit dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Komisioneri vlerëson dhe kontrollon mënyrën se si institucionet, organizatat, shoqëritë apo bizneset përpunojnë të dhënat personale të fëmijëve dhe të të miturve, duke siguruar që mbledhja dhe përdorimi i tyre të bëhet në përputhje me **ligjin nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"**.

Komisioneri gjithashtu jep udhëzime dhe rekomandime për subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre me fokus të miturit, në mënyrë që të zbatojnë me rigorozitet parimet e përcaktuara në **ligjin nr. 124/2024**.

Ai kryen kontrole periodike dhe inspektime për të verifikuar respektimin e ligjit, shqyrton ankesat e individëve për cënim të të dhënave personale si dhe ndërmer masa korrigjuese ose sanksione administrative, kur konstatohet keqpërdorimi i tyre.

Komisioneri organizon fushata informuese, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve, prindërve dhe vetë të miturve mbi të drejtat e tyre në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

5 Ai harton udhëzime të posaçme mbi përdorimin e sigurt të të dhënave personale në mjedisin online.





Cilat janë të drejtat e të miturve si subjekte të të dhënave personale?

Kur bëhet fjalë për të dhënat personale të gjithë gëzojmë një sërë të drejtash. Këto të drejta mund të ushtrohen edhe nga ju si të mitur, nëpërmjet prindit ose kujdestarit ligjor, për aq kohë sa i kuptoni ato dhe ushtrimi i tyre është në interesin tuaj.

1. E drejta për informim

Të miturit kanë të drejtë të informohen qartë dhe në mënyrë të kuptueshme për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të tyre personale, përfshirë qëllimin e përpunimit, kohëzgjatjen e ruajtjes dhe subjektet, me të cilat ndahen këto të dhëna. Ky informacion duhet të jepet në formë konçize, transparente, lehtësisht të arritshme dhe me gjuhë të thjeshtë, të përshtatshme për moshën.

2. E drejta për akses

Të miturit kanë të drejtë të informohen qartë dhe në mënyrë të kuptueshme për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të tyre personale, përfshirë qëllimin e përpunimit, kohëzgjatjen e ruajtjes dhe subjektet, me të cilat ndahen këto të dhëna. Ky informacion duhet të jepet në formë konçize, transparente, lehtësisht të arritshme dhe me gjuhë të thjeshtë, të përshtatshme për moshën.

3. E drejta për korigjim dhe fshirje

Të miturit kanë të drejtë të informohen qartë dhe në mënyrë të kuptueshme për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të tyre personale, përfshirë qëllimin e përpunimit, kohëzgjatjen e ruajtjes dhe subjektet, me të cilat ndahen këto të dhëna. Ky informacion duhet të jepet në formë konçize, transparente, lehtësisht të arritshme dhe me gjuhë të thjeshtë, të përshtatshme për moshën.


4. E drejta për t'u harruar

Të miturit kanë të drejtë të informohen qartë dhe në mënyrë të kuptueshme për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të tyre personale, përfshirë qëllimin e përpunimit, kohëzgjatjen e ruajtjes dhe subjektet, me të cilat ndahen këto të dhëna. Ky informacion duhet të jepet në formë konçize, transparente, lehtësisht të arritshme dhe me gjuhë të thjeshtë, të përshtatshme për moshën.

5. E drejta për kufizimin e përpunimit

Të miturit kanë të drejtë të informohen qartë dhe në mënyrë të kuptueshme për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të tyre personale, përfshirë qëllimin e përpunimit, kohëzgjatjen e ruajtjes dhe subjektet, me të cilat ndahen këto të dhëna.

Ky informacion duhet të jepet në formë konçize, transparente, lehtësisht të arritshme dhe me gjuhë të thjeshtë, të përshtatshme për moshën.



6. E drejta për transferueshmërinë e të dhënave

E drejta për transferueshmërinë e të dhënave është e drejta e të miturve, prindërve ose kujdestarëve të tyre të marrin informacion personal të fëmijëve në një format të përdorshëm, të sigurt dhe ta transferojnë atë tek një tjetër institucion ose shërbim pa humbur të dhëna. Kjo e drejtë mbron të dhënat personale të fëmijës, duke siguruar që informacioni të mos humbasë ose të përdoret në mënyrë të gabuar.


7. E drejta për të kundërshtuar

E drejta për të kundërshtuar u garanton të miturve, drejtpërdrejt ose përmes prindërve apo përfaqësuesëve ligjorë, mundësinë për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave të tyre personale, veçanërisht kur ky përpunim mund të cenojë interesin më të lartë të fëmijëve. Kjo e drejtë synon të sigurojë që të dhënat e të miturve të përdoren në mënyrë të drejtë, të ligjshme dhe transparente, duke marrë parasysh cenueshmërinë e tyre dhe nevojën për një nivel më të lartë mbrojtjeje.


8. E drejta për të mos i'u nënshtuar vendimeve automatike

E drejta për të mos i'u nënshtuar vendimeve automatike është e drejta e të miturve, duke siguruar që ndikimi i teknologjisë të jetë i kontrolluar dhe duke i dhënë mundësinë prindërve ose kujdestarëve të ndërhyjnë kur vendimi është i dëmshëm ose i gabuar, duke i dhënë mundësinë e rishikimit nga personat përgjegjës. Kjo përfshin vendimet që mund të kenë pasoja për fëmijët, si për shembull përfitime, regjistrime, ose shërbime që ndikojnë në jetën e tyre.

Edhe nëse jeni ju përgjegjës për të dhënat tuaja personale, kjo nuk do të thotë se nuk mund të kërkonit ndihmën e prindërve tuaj. Përkundrazi, në disa raste mund të jetë në interesin tuaj më të mirë që ushtrimi i të drejtave për mbrojtjen e të dhënave të bëhet me ndihmën e prindit ose kujdestarit ligjor.



Informohuni mbi përdorimin



e të dhënave personale

Fëmijët kanë të drejtë të informohen gjithmonë për mënyrën se si dhe për çfarë qëllimi përdoren të dhënat e tyre personale. Kjo quhet “e drejta për t’u informuar” dhe është e rëndësishme sepse ju ndihmon të kuptoni se kush e ka informacionin tuaj personal, si po e përdorin atë dhe si mund ta mbron.



Shoqëritë tregtare që mbledhin të dhënat tuaja personale duhet t’ju sqarojnë se: *kush janë, çfarë po bëjnë me të dhënat tuaja, përse i mbledhin dhe për sa kohë do t’i ruajnë ato.* Ky informacion duhet të jetë i qartë dhe i lehtë për t’u kuptuar, dhe nëse ka vështirësi mund të kërkon ndihmën e prindërve ose kujdestarëve ligjorë.

Zakonisht subjektet që përpunojnë të dhënat personale e vendosin këtë informacion në një dokument të quajtur politikë privatësie (*privacy policy*), i cili gjendet në faqen e tyre të internetit. Platformat dhe aplikacionet online shpesh ofrojnë njoftime në ekran sidomos kur ndryshohen cilësimet e llogarisë ose publikohen foto/video.


Për shembull, kur krijoni një llogari në një lojë apo aplikacion online mund t’ju shfaqet një mesazh që tregon se çfarë të dhënash mblidhen, përse dhe si mund t’i kontrolloni ato. Duke i lexuar me kujdes këto njoftime mund të vendosni vetë se çfarë dëshironi të ndani dhe si do t’i përdorni të dhënat tuaja.

Edhe pse lexime të tilla mund t’ju duken të gjata apo të lodhshme ato përmbajnë informacione shumë të rëndësishme për të mbrojtur të dhënat personale. Duke kuptuar se çfarë po ndodh me të dhënat tuaja, ju keni kontroll mbi to, mund të merrni vendime të ndërgjegjshme dhe të mbroheni nga përdorimi i tyre në mënyrë të gabuar.

Të dini se çfarë po ndodh me të dhënat është themeli i mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtave tuaja.



Çfarë janë të dhënat



personale në internet?

Të mbroni të dhënat personale do të thotë të keni kontroll mbi informacionin që tregoni për veten dhe të merrni vendime të kujdeshme për mënyrën se si ky informacion mblidhet, përdoret dhe ndahet me të tjerët, qofshin këta persona nuk i njihni, shoqëri apo institucione shtetërore. Të dhënat personale janë ato informacione që tregojnë se kush jeni dhe që ju bëjnë të identifikueshëm.

Informacion personal konsiderohet:

- emri dhe mbiemri;
- adresa;
- data e lindjes;
- fotografitë dhe videot personale;
- preferencat tuaja etj.

Nëse jeni duke përjetuar shpërndarje të paautorizuar të të dhënave personale apo fotove, Komisioneri ka autoritetin të ndërhyjë zyrtarisht për të:

- kërkuar heqjen apo fshirjen e menjëhershme të tyre duke u bazuar në ankesën tuaj dhe në provat që paraqisni;
- nisur hetim administrativ;
- kontaktuar platformën sociale ose/dhe institucionet shkollore për të siguruar trajtimin e rastit me seriozitet dhe në përputhje me ligjin.

Rreziqet e cenimit të të dhënave personale

Të dhënat tuaja personale në internet mund të përdoren në mënyrë të atillë që mund të sjellin cenimin tuaj pa e kuptuar, prandaj është e domosdoshme që informacioni juaj të mbrohet për të shmangur keqpërdorimet si në rastet kur:

- shoqëritë mund të gjurmojnë aktivitetet tuaja në internet dhe të krijojnë profile të detajuara rreth jush me qëllim dërgimin e reklamave të profilizuara ose për arsye të tjera, duke ndikuar në zgjedhjet tuaja madje edhe në mënyrën e të menduarit;
- informacionet që preferoni t'i mbani private ose që mund të jenë të pasakta, mund të publikohen në internet nga palë të treta;
- informacioni që publikoni në internet, mund të qëndrojë aty përgjithmonë dhe mund të bëhet shkak se si miqtë, mësuesit, punëdhënësit etj në të ardhmen të mendojnë për ju;



- në një moment të caktuar të jetës do të reflektoni mbi atë çka keni publikuar më herët në mjedisin online dhe pavarësisht se do të dëshironi ta fshihni atë, do të zbuloni se nuk mundeni më;
- mungesa e mbrojtjes së të dhënave personale në internet mund t'ju bëjë të cënueshëm ndaj bullizmit kibernetik dhe madje mund të rrezikojë sigurinë tuaj fizike në botën reale;
- persona të panjohur mund t'ju mashtrojnë për të marrë informacion me qëllim aksesin në llogaritë bankare, tuaja apo të familjes.

(Në shumicën e rasteve mund të jetë e vështirë për t'i evidentuar këta persona që ushtrojnë veprimtari të paligjshme.)

Si të mbroni të dhënat tuaja në mjedisin online?



1. Përdorni fjalëkalime të forta

Zgjidhni fjalëkalime të lehta për t'u mbajtur mend, por të vështira për t'u gjetur nga të tjerët. Mos përdorni të dhëna të tilla si emrin/mbiemrin tuaj, ditëlindjen, emrin e një kafshe/sendi apo vendi të preferuar. Fjalëkalimet duhet të kenë të paktën 12 karaktere, një kombinim shkronjash, simbolesh dhe numrash.

2. Kontrolloni faqet dhe aplikacionet përpara se t'i përdorni.

Verifikoni paraprakisht me prindërit, mësuesit ose kujdestarët ligjorë nëse aplikacioni apo loja është e përshtatshme për moshën tuaj. Lexoni së bashku kushtet e përdorimit dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Përdorni pajisje të sigurta

Kur lidheni në internet, përdorni pajisje që janë në shtëpinë tuaj dhe të mbrojtura me fjalëkalime, kështu është më e lehtë të qëndroni të sigurt dhe të kërkonti ndihmë nëse hasni vështirësi.

4. Kontrolloni cilësimet e llogarive

Shumica e aplikacioneve apo lojërave online kanë cilësime apo menunë "settings", e cila ju ndihmon që t'i përshtatni sipas dëshirës. Shumë prej tyre vijnë me "settings të parazgjedhura të privatësisë", që janë cilësimet bazë për të mbrojtur informacionin tuaj personal. Kontrolloni dhe forconi cilësimet tuaja të privatësisë me ndihmën e prindërve, mësuesve ose kujdestarëve ligjorë. Fillimisht, vendosni llogaritë tuaja në formatin "private", çaktivizoni vendndodhjen tuaj dhe kufizoni se kush mund t'ju bëj miq dhe t'ju dërgojë mesazhe.



5. Konsultohuni përpara se të jepni të dhënat personale

Pyesni gjithmonë prindërit, mësuesit ose kujdestarët ligjorë përpara se të jepni të dhënat personale, pasi disa kompani kërkojnë më shumë informacion nga sa është e nevojshme. Zakonisht informacionet jepen me vullnet të lirë, por ndonjëherë pa e kuptuar mund të jepni më shumë se ç'duhet.

6. Mos zbuloni të dhënat personale në lojra

Kur luani video-lojra online, mos ndani asnjë informacion në profilin tuaj që mund t'ju identifikojë ju apo vendndodhjen tuaj, përdorni një emër dhe figurë të rremë (avatar).

7. Komunikoni vetëm me njerëzit që njihni

Në rrjetet sociale, lojrat apo aplikacionet e komunikimit, sigurohuni të pranoni vetëm personat që njihni pasi mund të jetë e pasigurt të komunikoni ose të luani me njerëz të panjohur.

8. Kujdesuni nga mashtrimet dhe lidhjet e pasigurta

Mos klikoni në lidhje (link) nëse nuk jeni të bindur që janë të sigurta dhe mos shpërndani ose shkarkoni informacione në to. E-mail-et dhe mesazhet që mund të mbërrijnë në telefonin/kompjuterin tuaj në pamje të parë mund të duken të ligjshme, por ka raste që ato janë instrumenta që përdoren për t'ju mashtruar.

9. Mendoni para se të postoni

Kujdesuni për atë që shpërndani në internet, pasi publikimi i të dhënave tuaja mund të qëndrojë në këtë mjedis përherë dhe më pas mund të kopjohet, ndryshohet apo përdoret për qëllime të padëshiruara.

10. Kërkoni ndihmë kur ndiheni të pasigurt

Nëse gjatë lundrimit në internet diçka ju shqetëson, apo mendoni se keni vepruar gabim me të dhënat tuaja, mos hezitoni të kërkoni menjëherë ndihmën e prindërve, kujdestarëve ose mësuesëve tuaj.

11. Mos harroni të shkëputeni nga mjedisi online

Përpiquni të qëndroni sa më pak në mjedisin online dhe të zgjidhni forma të tjera argëtimi si leximi, sportet, artet apo shëtitjet në park me shokët ose prindërit tuaj.

Ky udhëzues ka për qëllim që jo vetëm të ndihmojë të miturit në mbrojtjen e të dhënave të tyre personale në internet, por edhe të ndërgjegjësojë prindërit/kujdestarët për sigurinë dhe mirëqënien e fëmijëve të tyre gjatë përdorimit të pajisjeve teknologjike dhe lundrimit në internet.

Nëse keni paqartësi mbi këtë udhëzues, mund të paraqiteni fizikisht për t'u konsultuar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, apo të kërkoni më shumë informacion përmes postës elektronike dhe komunikimit telefonik.

Zyra e Komisionerit mbetet e angazhuar për t'ju informuar me shpejtësi dhe efikasitet mbi mbrojtjen e të dhënave personale.







Rruga "Abdi Toptani", Nd. 5, 1001, Tiranë

Për më shumë informacion mbi
Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
mund të vizitoni faqen zyrtare: www.idp.al ose kontaktoni në adresën elektronike: info@idp.al

Ky material është përshtatur në mënyrë të veçantë për të miturit, me qëllim informimin
dhe ndërgjegjësimin e tyre lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.